



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:267960

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644102

C.nr.1094/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË / Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Hatixhe Begaj, me zyrtaren ligjore Albanë Morina, në çështjen juridike të paditësve: A. K., H.M., G. H. dhe B. Hoti, të punësuar pranë Gjimnazit “Hamdi Berisha” në M., të cilët i përfaqëson avokat Zahir Hamza nga Prishtina, sipas autorizimeve në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë - shujtave ditore, vlera e kontestit 952.00 euro, jashtë shqyrtimit me datë 30.04.2024 merr këtë:

**A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve A. K., H.M., G. H. dhe B. H., të punësuar pranë Gjimnazit “Hamdi Berisha” në M., ashtu që **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës - shujtave ditore, t’ua paguajë paditësve si në vijim:

- Paditësit A. K., t’ia kompensojë *shumën në lartësi të përgjithshme prej 238,00 euro*, për 119 ditë nga 2 (dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, për vitin shkollor 2020-2021 (01.01.2021-31.07.2021).
- Paditësit H. M., t’ia kompensojë *shumën në lartësi të përgjithshme prej 238,00 euro*, për 119 ditë nga 2 (dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, për vitin shkollor 2020-2021 (01.01.2021-31.07.2021).
- Paditëses G. H., t’ia kompensojë *shumën në lartësi të përgjithshme prej 238,00 euro*, për 119 ditë nga 2 (dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, për vitin shkollor 2020-2021 (01.01.2021-31.07.2021).
- Paditësit B. H., t’ia kompensojë *shumën në lartësi të përgjithshme prej 238,00 euro*, për 119 ditë nga 2 (dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, për vitin shkollor 2020-2021 (01.01.2021-31.07.2021).

Të gjitha shumat e lartëcekura, detyrohet e paditura që paditësve të iu paguajë me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet që nga dita e paraqitjes së padisë dt.11.11.2021, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim që paditësve t’ua kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 281.00 euro, ndërsa pjesa

tjetër e shpenzimeve të procedurës mbi shumën e aprovuar REFUZOHET, konkretisht shuma prej 338.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësit A. K., H.M., G. H. dhe B. Hoti, të punësuar pranë Gjimnazit “Hamdi Berisha” në M., të cilët i përfaqëson av. Zahir Hamza nga Prishtina, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi me dt.11.11.2021, kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike kompensim për shujtat ditore të paraparë me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, deklaruar që paditësit kërkojnë të paguhen në emër të shujtave ditore, për paditësin A. K., për periudhën nga viti 2020-2021 për 119 ditë pune shumën prej 238 euro, për paditësin H. M. për periudhën nga viti 2020-2021 për 119 ditë pune shumën prej 238 euro, për paditëse G. H., për periudhën nga viti 2020-2021 për 119 ditë pune shumën prej 238 euro, për paditësin B.H., për periudhën nga viti 2020-2021, për 119 ditë pune shumën prej 238 euro, pra për secilin paditës shumën prej 2 euro, sipas vërtetimeve të lëshuara nga shkolla, në shumën e përgjithshme për të gjithë prej 952 euro, të gjitha këto me kamatë prej 8 % nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar në vlerën prej 260 €uro në emër të përpilimit të padisë, për seancë shumen në vlerë prej 338 euro si dhe 21 euro në emër të taksës për padi.

E paditura përmes përgjigjes së saj në padi ndër të tjera ka theksuar se lidhur me pagesën e shujtës sipas kontratës kolektive dt.22.01.2021 neni 35 të pika 7 dhe atë për vitin 2017 dhe 2021, lidhur me këtë rast paditësve në fjalë të njëjtat shuma i kanë kërkuar për pagesën e shujtës për vitin 2021, paditësja G. H., e punësuar në gjimnazin “Hamdi Berisha”, e që mban numrin e padisë C.nr.756/22, ku ka kërkuar t’i realizohet kërkesa për vitin 2021-2022, në shumën prej 370 euro. I propozoj Gjykatës Themelore Gjakovë Dega Malishevë, që ta hedh poshtë padinë e paditësve si të pa bazuar C.nr.756/22.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Themelësia e kërkesëpadiisë del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht nga vërtetimi me nr.prot.291/21 të datës 19.10.2021, për paditësin A. K., vërtetimi me nr.prot.297/21 të dt.21.10.2021 për paditësin H.M., vërtetimi me nr.prot.298/21 të datës 21.10.2021 për paditësen G. H. dhe vërtetimi me nr.prot.274/21 të dt.11.10.2021, për paditësin B. H., të lëshuar nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët “Hamdi Berisha”, në M., nga të cilat vërtetohet se paditësit janë në marrëdhënie pune të e paditura si mësimdhënës në këtë shkollë, si dhe nga të njëjtit vërtetohet vijueshmëria në punë e paditësve për vitin 2020/2021, periudhë kjo për të cilën të gjithë paditësit e lartëcekur kërkojnë kompensimin e shujtave të ushqimit për 119 ditë pune për secilin, të cilave prova gjykata ia fali besimin e plotë duke u bazuar edhe në nenin 329.1, të LPK-së, në të cilin përcaktohet që *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, pasi janë lëshuar nga institucionet arsimore të së paditurës.

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura në punë në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët

“Hamdi Berisha” në M., ndërsa kontestues mes palëve ndërgjyqëse rezulton të jetë e drejta në kompensimin në emër të kompensimit të shujtave ditore.

Sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, është paraparë se: 35.7 *”Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Sipas dispozitës në fjalë paditësve u takojnë shpenzimet e ushqimit.

Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës Nr.03/L-212, neni 90 par. 5 e që përcakton se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*, e që nënkupton detyrimin e punëdhënësit përkatësisht të paditurës për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, e njëjta e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që prodhon efekt juridik për punëdhënësit që kanë të punësuar, sepse të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë dhe e paditura është punëdhënës i paditësve prandaj detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë.

Njëkohësisht, meqenëse u konstatua se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër faktit se e paditura e ka kontestuar vlerën e borxhit sa i përket kompensimit të mjeteve në emër të shujtave ditore, megjithatë për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme, dhe si të tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes, sipas dispozitës së nenit 152 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, e që në këtë rast e paditura përmes përgjegjës në padi nuk i ka kontestuar fare faktet vendimtare përveç që është e kontestuar e drejta e kompensimit të shujtave ditore si e pa bazuar në kontratën kolektive, andaj gjykata duke interpretuar të njëjtën me dispozitat e nenit 396 par.2 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se *“Po që se i padituri e konteston kërkesëpadinë, përgjigja në padi duhet t’i përmbajë edhe faktet mbi të cilat i padituri i mbështetë thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e tilla”*, në çështjen konkrete juridike vlerëson se paditura nuk i ka bashkangjitur asnjë provë konkrete parashtresës së përgjigjes në padi, me të cilat do të vërtetonte pretendimet e saj, se paditësit janë kompensuar me herët.

Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes, sipas dispozitës së nenit 152 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, e që në këtë rast e paditura përmes përgjegjës në padi nuk i ka kontestuar fare faktet vendimtare përveç që është e kontestuar e drejta e kompensimit të shujtave ditore me arsyetimin se të njëjtat kanë kërkuar kompensimin në fjalë me padi të tjera, andaj gjykata duke interpretuar dispozitën e nenit 396 par.2 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se *“Po që se i padituri e konteston kërkesëpadinë, përgjigja në padi duhet t’i përmbajë edhe faktet mbi të cilat i padituri i mbështetë thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e tilla”*, në çështjen konkrete juridike vlerëson se paditura ka bashkangjitur prova mirëpo të njëjtat nuk provojnë faktet të cilat do të ndikonin në marrjen e një vendimi tjetër dhe me të cilat do të vërtetonte pretendimet e saj.

Gjykata analizoi pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi, sipas të cilit paditësit kanë ngritur padi tjera për kompensim shujte, mirëpo gjykata gjen se këto pretendime nuk qëndrojnë pasi që këto lënd janë të ngritura nga paditësit e njëjtë mirëpo periudha kohore për të cilat kërkohet kompensimi për shujtat ditore ndryshon nga padia aktuale, e kjo u vërtetua nga thëniet e paraqitura në përgjigje në padi ku thuhet se G. H. ka kërkuar ti kompensohen shpenzimet e pagesës së shujtës pr vitin 2021-22 në shumën prej 370, ndërsa në rastin tonë janë kërkuar për vitin 2020-2021 konkretisht nga muaji janar deri në muajin korrik të vitit 2021, e që vërtetojnë faktin se nuk kemi të bëjmë me periudhën e njëjtë kohore, andaj meqenëse i padituri nuk ka sjellur prova të tjera për të mbështetur pretendimet e tij gjykata i mori si të pabazuara këto pretendime.

Gjykata gjeti se kërkesëpadija e paditësve është e bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se për periudhën për vitin shkollor 2020-2021 (01.01.2021-31.07.2021) paditësit kanë gjithsej nga 119 ditë pune secili prej tyre, dhe atyre iu takojnë shpenzime të ushqimit për çdo ditë pune nga 2€uro (119 x 2=238.00€uro) e që është shuma prej 238.00 €uro për secilin paditës. Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve t'iu paguaj shpenzimet e ushqimit (shujtave) në punë.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ka marr datën e ushtrimit të padisë (data 11.11.2021), e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet shumës prej 260 euro për përpilim padie dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 20 euro, ndërsa shuma mbi vlerën e aprovuar për padi, konkretisht shuma prej 156 euro për përpilimin e padis është refuzuar duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve numri tarifor 6, si dhe shuma prej 338 e kërkuar për seancë u refuzua nga gjykata për faktin e nxjerrjes së aktgjykimit pa mbajtur seancë fare.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 152 të LPK-së, e në lidhje me dispozitat e nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 par.1 dhe 2 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORË NË GJAKOVË- DEGA NË MALISHEVË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.1094/21 dt.30.04.2024

**Gjyqtarja
Hatixhe Begaj**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.